



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:031686

Datë: 31.07.2023

Numri i dokumentit: 04540451

P.nr.637/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ertan Sejfulla, me bashkëpunëtorin profesional Eduart Aliu në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh.D, për shkak të veprës penale “*Pengim i Personit Zyrtar në Kryerjen e Detyrave Zyrtare*” nga neni 409 paragrafi 5, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr. 1211/19, datë 27.02.2020, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Menduhi Kastrati, të akuzuarit Sh.D, me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare Av. M.I, më datë 26.07.2023 mori dhe të njëjtën datë shpalli, ndërsa me datë 31.07.2023, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit:

SH.D, nga babai, nëna, e vajzërisë, i lindur më datë, në, Rruga “.....”, pa, Komuna e,, i, i gjendje, me numër personal, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Më datë 27.02.2019, rreth orës 09:00, Zyrtarët e Inspektionit Komunal së bashku me një njësi të komunikacionit rrugor nga Policia, në rrugën “.....”, në, kishin takuar të akuzuarin Sh.D, duke ushtruar veprimtari taksie pa leje përkatëse me veturën e tij VW Golf 4, ngjyrë e kaltër, me targa-.....-..... dhe në moment që i akuzuari kupton se inspektorët janë duke ia shqiptuar gjobën, i afrohet veturës zyrtare të inspektorëve dhe me forcë ua merr dokumentet nga dora dhe tenton të largohet, por zyrtarët policor i marrin përsipër

dokumentet dhe rifillojnë më procedura, ku i akuzuari i lartcekur vazhdimisht i ka penguar inspektorët dhe policët duke lejuar të kryejnë detyrën e tyre zyrtare,-

- Me këtë ka kryer veprën penale “*Pengim i Personit Zyrtar në Kryerjen e Detyrave Zyrtare*” nga neni 409 paragrafi 5, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjykata, në kuptim të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 45, 49, 50, 51, 52 dhe 73, të KPRK-së, si dhe neneve 242, 358, 360, 364, 449, 452 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

- I.** Të akuzuarit **Sh.D**, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 2 (dy) vite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.
- II.** Obligohet i akuzuari që t’i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale, në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë Euro (30.00 euro) si dhe në emër të taksës për programin e kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet euro (20.00 euro), obligohet që këto shpenzime ti paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Për shpenzimet tjera eventuale gjykata do të vendos me aktvendim të posaçëm pas përllogaritjeve të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzën e evidentuar me numër PP.II.nr. 1211/19, datë 27.02.2020, kundër të akuzuarit Sh. D, për shkak të veprës penale “*Pengim i Personit Zyrtar në Kryerjen e Detyrave Zyrtare*” nga neni 409 paragrafi 5, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjykata me datë 26.07.2023, ka mbajtur vazhdimin e seancës së shqyrtimit fillestar, në të cilin shqyrtim të pranishëm kanë qenë Prokurori i Shtetit Menduhi Kastrati, i akuzuari Sh.D dhe mbrojtësja e të akuzuarit sipas detyrës zyrtare Av.M.I. Prokurori i Shtetit e lexon aktakuzën, gjykata i ofron mundësinë të akuzuarit që të deklarohet lidhur me pranimin e fajësisë ose të deklarohen të pafajshëm, lidhur me akuzën e cila i është ngritur nga Prokuroria.

I akuzuari Sh.D deklaroi se e pranoi fajësinë, shton se ka qenë diçka e rastit, ka shprehur keqardhje, kërkoi falje është për këtë rast, jam mbajtës i vetëm i familjes, nuk kam pasur të ardhura për të paguaj gjobën, prandaj kam reaguar, i premtoj gjykatës se më nuk do të përsëris vepra të tilla, si dhe kërkoj një dënim sa më të butë.

Mbrojtësja e të akuzuarit deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë së cili është bërë pas konsultimit të mjaftueshëm me të mbrojturin tim lidhur me benefitet dhe pasojat e pranimi të veprës penale, i njëjti i ka kuptuar këto dhe është deklaruar se e pranon veprën penale, fajësinë e ka pranuar në të gjitha fazat e procedurës ashtu siç e pranoi edhe në këtë seancë. I mbrojturi im ndjen keqardhje për veprimet të cilat i ka ndërmarrë në ditën kritike e që kanë qenë të atëzastshme mirëpo i njëjti menjëherë pas këtyre veprimeve u ka kërkuar falje inspektionit dhe policëve të cilët kanë qenë duke e kryer detyrës zyrtare, i njëjti ka ra ndesh për herë të parë me ligjin, është familjar, mbajtës i vetëm i familjes, i gjendjes së dobët ekonomike, është i papunësuar, ashtu që kërkojmë nga gjykata një dënim sa më të butë. Gjithashtu si mbrojtëse e të akuzuarit i propozojë gjykatës që me rastin e matjes së dënimit ndaj të mbrojturit tim ti ketë parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe atë shkallën e përgjegjësisë penale, sjellën e mëparshme të kryerësit, pranimin e fajësisë ashtu që të ketë parasysh edhe rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit të paraparë me nenin 74 dhe 75 të KPRK-së, ashtu që gjykata të njëjtit t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë me anë të cilit do të arrihet edhe vet qëllimi i dënimit konform nenit 41 të KPRK-së

Prokurori i Shtetit deklarohet lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë sepse ky pranim fajësie ka mbështetje në shkresat e lëndës, si dhe bazë ligjore në nenin 242 të KPP-së, andaj i propozojë gjykatës që pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ta vlerësojë si rrethane lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit

Pas pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjykata merr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga të akuzuarit, pasi që gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht dhe është mbështetur edhe në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Po ashtu, edhe nga shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit, ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale "*Pengim i Personit Zyrtar në Kryerjen e Detyrave Zyrtare*" nga neni 409 paragrafi 5, lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, si dhe vërtetoi gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata e shpalli fajtor të akuzuarin, pasi që më parë gjeti se është penalisht përgjegjës.

Me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë, shprehjen e keqardhjes, kërkim faljen, pendimin e tij, mbajtës i vetëm i familjes, premtimin se nuk do të përsërisë me vepra të tilla, ndërsa si rrethana rënduese nuk gjeti prandaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar kundër tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38, të KPRK-së, e që konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave

penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 449 paragrafi 2, pika 2.6 dhe 2.9 e lidhur me nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, e ngarkoi të akuzuarin lidhur me shpenzimet e procedurës, duke i obliguar të njëjtin që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20.00 € (njëzet euro). Ndërsa konform nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata e obligoi të akuzuarin të paguajë shumën prej 30 € (tridhjetë euro), në emër të taksës për Programin e Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, e në bazë të nenit 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.637/20, datë 31.07.2023

Bashkëpunëtori Profesional
Eduart Aliu

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ertan Sejfulla

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Kosovë në Prishtinë, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.